



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Nr. 2343A Prot.

Tiranë, më 24.6.2020

NJOFTIM

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatim të Ligjit nr.152/2013, datë 30.5.2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, Kreu V – *“Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë”*, neni 26 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.3.2015, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*, i ndryshuar, Njësia Përgjegjëse e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, njofton se:

Nga procedura *“Lëvizja paralele”*, për 1 (një) vend të lirë pune në kategorinë e nëpunësve civilë të mesëm drejtues, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Administrimit në ILDKPKI, nuk është paraqitur asnjë kandidaturë dhe pozicioni i lartpërmendur rezulton ende vakant.

Procedura për lëvizje paralele mbyllet pa asnjë kandidat.

Konkurrimi do të vazhdojë sipas Kreut V – *“Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë”*, të Ligjit nr.152/2013, datë 30.5.2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242, datë 18.3.2015 *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*, i ndryshuar, Kreu III, *“Ngritja në detyrë”*.

Për sqarime mund të kontaktoni në adresën e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Rruga *“Reshit Çollaku”*, Tiranë.

ILDKPKI
NJËSIA PËRGJEGJËSE